



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1271 Prot.

Tiranë, më datë 16.12.2020

**VENDIM**  
**Nr. 485, datë 16.12.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.12.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fazës së projekt zbatimit: “Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në 4 objekte pasuri kulturore “Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras Kurbini””; me aplikues FOCUS Architecture;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**  
**Arta DOLLANI**

Arta  
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani  
DN: cn=AL, o=Instituti i  
Monumentave te Kultures,  
title=Direktor i Pergjithshem,  
ou=Arta Dollani  
Date: 2020.12.16 17:05:15  
+0100

Elva  
Margariti

Digitally signed  
by Elva Margariti  
Date: 2020.12.16  
18:04:22 +01'00'